

URDHËR
Nr. 409, datë 19.7.2021

**PËR MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS DHE TË SJELLJES PROFESIONALE PËR
POLICINË E BURGJEVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Kodi i etikës dhe i sjelljes profesionale për Policinë e Burgjeve”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë për ndjekjen e këtij urdhri dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e tij.
 3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

**KODI I ETIKËS DHE I SJELLJES PROFESIONALE
PËR POLICINË E BURGJEVE**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij Kodi është përcaktimi i udhëzimeve dhe rregullave të etikës, standardeve gjithëpërfshirëse të komunikimit, si dhe parimeve e standardeve profesionale të sjelljes, gjatë ushtrimit të detyrave të punonjësit të Policisë së Burgjeve.

Neni 2
Qëllimi

Ky Kod ka si qëllim përcaktimin e vlerave, parimeve, udhëzimeve dhe rregullave nga të cilat udhëhiqet punonjësi i Policisë së Burgjeve, në përmbushjen e misionit të tij për sigurinë, trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurve, si dhe promovimin e një kulture profesionale në mjedisin e punës.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Ky Kod zbatohet për çdo punonjës të Policisë së Burgjeve, që ushtron veprimtarinë e tij në nivel qendror, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe gjatë transferimit apo shoqërimit të personave të burgosur.

KREU II PARIMET THEMELORE

Neni 4 **Parimet bazë të etikës**

Punonjësi i Policisë së Burgjeve kryen veprimtarinë e tij, në përputhje me parimet si më poshtë, por pa u kufizuar në to:

- a) parimin e ligjshmërisë;
- b) parimin e objektivitetit;
- c) parimin e drejtësisë, paanshmërisë dhe mosdiskriminimit;
- ç) parimin e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave;
- d) parimin e integritetit;
- dh) parimin e profesionalizmit;
- e) parimin e përgjegjshmërisë.

Neni 5 **Parimi i ligjshmërisë**

Punonjësi i Policisë së Burgjeve ushtron veprimtarinë, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tij dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.

Neni 6 **Parimi i objektivitetit**

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, në ushtrim të kompetencave të tij, është objektiv, i pavarur, i ndershëm dhe i ndërgjegjshëm për detyrimet etike e profesionale.

2. Gjatë realizimit të detyrave të ngarkuara, punonjësi i Policisë së Burgjeve mbështetet në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e personave të burgosur, ruajtjes e sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe në komunikimin e informacioneve me profesionalizëm, pa u ndikuar nga interesi i tij ose i të tjerëve.

3. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, në realizimin e detyrave, aplikon parimet e barazisë, të drejtësisë dhe të moralit, duke parandaluar çdo sjellje që cenon këto parime. Punonjësi i Policisë së Burgjeve tregohet i kujdesshëm për të mos gënjyer apo shtrembëruar faktet.

Neni 7 **Drejtësia, paanshmëria dhe mosdiskriminimi**

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ndalohet të kryejë çdo lloj diskriminimi ndaj të burgosurit, personelit dhe vizitorëve, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë.

3. Të burgosurit, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në raste të veçanta, kur bëhet një trajtim i diferencuar, ky trajtim justifikohet vetëm nga karakteristikat objektive që lidhen me rastin e veçantë.

4. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, në ushtrimin e detyrave të tij, trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të burgosurit, personelin, vizitorët apo çdo person tjetër me të cilin krijon kontakt.

5. Punonjësit të Policisë së Burgjeve i ndalohet të cenojë parimin e prezumimit të pafajësisë të personave në proces gjykim.

Neni 8

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ruan konfidencialitetin e çdo informacioni të përfituar, për shkak të detyrës, me përjashtim të rasteve kur kërkohet informacion, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Në të gjitha rastet, punonjësi i Policisë së Burgjeve respekton parimet e konfidencialitetit mjekësor.

3. Mbledhja, ruajtja dhe përdorimi i të dhënave personale bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 9

Integriteti gjatë ushtrimit të detyrës

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve mbron dhe promovon standarde të larta të ndershmërisë dhe integritetit personal.

2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ruan marrëdhënie profesionale pozitive me të burgosurit, personelin, vizitorët apo çdo person tjetër me të cilin bie në kontakt për shkak të detyrës.

3. Në ushtrimin e veprimtarisë së tij punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk lejon që interesat e tij personale dhe financiare të bien ndesh me pozicionin e tij, shmang konfliktin e interesave dhe nuk shfrytëzon pozitën për interesin personal.

4. Punonjësi i Policisë së Burgjeve duhet të ketë paraqitje të rregullt, të ruajë dhe të respektojë uniformën e Policisë së Burgjeve, në përputhje me natyrën e punës për të përfaqësuar denjësisht institucionin ku punon.

5. Punonjësi i Policisë së Burgjeve shmang çdo sjellje të papërshtatshme, që bie në kundërshtim me ligjin dhe këtë Kod, si edhe ato veprime që mund të dëmtojnë ose të krijojnë dyshime mbi figurën e tij profesionale dhe morale.

Neni 10

Parimi i profesionalizmit

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve realizon detyrat e tij me profesionalizëm dhe përmirëson në vazhdimësi aftësitë e tij profesionale, nëpërmjet trajnimeve, konferencave dhe aktiviteteve të tjera, si dhe nëpërmjet rritjes individuale profesionale. Atij i ndalohet çdo veprim apo sjellje e papranueshme për pozicionin e tij në institucion.

2. Bazuar në parimin e profesionalizmit punonjësi i Policisë së Burgjeve:

a) zotëron njohuri dhe aftësi për të garantuar gjatë ushtrimit të detyrave të tij shërbim profesional; dhe

b) vepron me kujdes dhe në përputhje me standardet teknike dhe profesionale të zbatueshme.

3. Punonjësi i Policisë së Burgjeve respekton ligjet dhe rregullat e vendosura, si dhe mënjanon çdo veprim që cenon integritetin e tij profesional apo kompromenton aftësinë për të kryer detyrat profesionale.

4. Punonjësi i policisë duhet të ruajë të pastër figurën e tij morale, duke shmangur sjellje apo veprime të padenja që cenojnë autoritetin dhe imazhin e institucionit.

Neni 11

Parimi i përgjegjshmërisë

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ushtron drejtpërdrejt detyrat e tij dhe ka përgjegjësi administrative, penale dhe civile për to.

2. Gjatë kryerjes së detyrave, punonjësi i Policisë së Burgjeve zbaton njohuritë, aftësitë dhe eksperiencën e duhur.

KREU III

ETIKA DHE SJELLJA PROFESIONALE E POLICISË SË BURGJEVE

Neni 12

Kujdesi i duhur

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, trajton të burgosurit me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat themelore në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe të akteve ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.

2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve tregon kujdes ndaj nevojave të kategorive të veçanta të të burgosurve, si të miturve, grave, minoriteteve, të burgosurve të huaj, të moshuar apo me aftësi të kufizuara, si dhe çdo të burgosuri që mund të jetë i cenueshëm për arsye të tjera. Punonjësi i Policisë së Burgjeve bën çdo përpjekje për të përmbushur nevojat e kategorive të veçanta të të burgosurve.

3. Punonjësi i Policisë së Burgjeve garanton mbrojtjen e shëndetit të të burgosurit nën kujdesin e tij dhe ndërmer veprime të menjëhershme për të siguruar ndihmën mjekësore sa herë nevojitet.

4. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, me qëllim riintegrimin social të të burgosurit, ushtron detyrën, duke pasur në konsideratë programet e rehabilitimit social, veprimtaritë konstruktive, ndihmën dhe bashkëpunimin.

5. Në ushtrimin e detyrave të tij, punonjësi i Policisë së Burgjeve tregohet i kujdesshëm për të parandaluar shkeljet e ligjit nga persona të tretë.

Neni 13

Respektimi dhe përkrahja e dinjitetit njerëzor

1. Gjatë kryerjes së detyrave, punonjësi i Policisë së Burgjeve mbron dinjitetin njerëzor të të burgosurit.

2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, në asnjë rrethanë, edhe kur një gjë e tillë urdhërohet nga eprori, nuk duhet të shkaktojë, nxisë apo tolerojë akte torture, trajtimi ose ndëshkimi tjetër çnjerëzor apo degradues.

3. Punonjësi i Policisë së Burgjeve respekton dhe mbron integritetin fizik, seksual dhe psikologjik të të burgosurit, përfshirë sulmet nga të burgosurit e tjerë apo edhe nga kushdo tjetër.

4. Punonjësi i Policisë së Burgjeve trajton të burgosurin, personelin dhe vizitorët me edukatë dhe respekt.

5. Punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk cenon të drejtën e privatësisë të të burgosurit, personelit dhe vizitorëve, me përjashtim kur kjo parashikohet në ligj dhe është e domosdoshme për të arritur objektiva të caktuar.

6. Punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk përdor forcë fizike ndaj të burgosurit, me përjashtim të rasteve kur është i nevojshëm për vetëmbrojtje, për të ndaluar aktet e dhunshme, sulmin fizik ndaj një të burgosuri tjetër, tentativat e largimit nga institucioni, vetëdëmtimin, ose në rast të rezistencës aktive ose pasive ndaj një urdhri të ligjshëm. Forca përdoret si mjet i fundit dhe nuk duhet të ketë karakter ndëshkues.

7. Në çdo rast, punonjësi i Policisë së Burgjeve kryen kontrolle në respektim të dinjitetit të personave subjekt kontrolli.

Neni 14

Llogaridhënia

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve udhëhiqet nga parimi i llogaridhënies, është përgjegjës për sjelljen e tij dhe merr përsipër pasojat e veprimeve apo mosveprimeve të tij apo urdhrat e dhënë për vartësit.

2. Në të gjitha rastet punonjësi i Policisë së Burgjeve verifikon paraprakisht ligjshmërinë e veprimeve të tij.

Neni 15

Sjellja e punonjësit të Policisë së Burgjeve

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ushtron detyrën e tij në mënyrë korrekte, duke respektuar orarin e punës, përkrahur frymën e bashkëpunimit, mbështetjes, besimit reciprok dhe mirëkuptimit mes personelit, në çdo kohë dhe çdo situatë.

2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve shmang çdo sjellje e cila bie ndesh me rregullat e parashikuara në ligjin për të drejtat e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosur, rregulloren e përgjithshme të burgjeve, rregulloren e disiplinës për Policinë e Burgjeve, këtë Kod, si dhe çdo akt tjetër i cili parashikon detyrime për punonjësin e Policisë së Burgjeve.

3. Punonjësi i Policisë së Burgjeve nxit përgjegjshmërinë ndaj vetes, personelit, vizitorëve, publikut, si dhe respekton standardet bazë të sjelljes, si brenda, ashtu dhe jashtë mjedisit të institucionit.

4. Punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk duhet të komentojë në ambiente publike mbi sjelljes apo ecurinë në punë të kolegëve të tij, pavarësisht pozicionit të tyre.

5. Në ushtrimin e detyrave të tij, punonjësi i Policisë së Burgjeve komunikon në gjuhë formale me personat me të cilët ka kontakt dhe zbaton rregullat e mirësjelljes së përgjithshme.

6. Punonjësit të Policisë së Burgjeve i ndalohet të krijojë raporte intime në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale apo me personat e burgosur.

Neni 16

Paraqitja e punonjësit të policisë

1. Gjatë ushtrimit të detyrës, punonjësi i Policisë së Burgjeve mban uniformën të rregullt, ku të dallohen në mënyrë të qartë shenjat e veçanta personale dhe të shërbimit, si dhe gradat.

2. Paraqitja në punë duhet të jetë e përshtatshme dhe e tillë që të shprehë kujdesin dhe seriozitetin e vazhdueshëm të punonjësve të Policisë së Burgjeve, për pamjen e tyre të jashtme dhe nivelin e domosdoshëm të pastërtisë personale.

3. Punonjësi tregohet i kujdesshëm për paraqitjen e tij edhe jashtë institucionit dhe orarit zyrtar të punës.

4. Punonjësit i ndalohet të veshë veshje të papërshtatshme apo provokative në publik.

5. Punonjësit të Policisë së Burgjeve i ndalohet të marrë pjesë në aktivitete që kërkojnë shfaqjen e trupit të tij.

Neni 17

Pijet alkoolike dhe pirja e duhanit

1. Punonjësit të Policisë së Burgjeve i ndalohet:

a) mbajtja e piqeve alkoolike në zyrat dhe mjediset e institucionit;
b) konsumimi i piqeve alkoolike, si brenda, ashtu dhe jashtë institucionit, gjatë kohëzgjatjes normale të punës.

2. Në të gjitha mjediset e institucionit është e ndaluar pirja e duhanit. Ajo mund të lejohet vetëm në vendet e caktuara për këtë qëllim.

Neni 18

Veprimtaritë e jashtme

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk duhet të angazhohet në një veprimtari të jashtme, që pengon kryerjen e detyrës së tij ose që kërkon një angazhim, mendor a fizik të tij, që e bën të vështirë kryerjen e detyrës ose është vazhdim i kësaj detyre, që cenon, në çfarëdo mënyre, imazhin e punonjësit të Policisë së Burgjeve.

2. Në rast dyshimi për kualifikimin e një veprimtarie si të lejueshme ose jo, punonjësi i Policisë së Burgjeve këshillohet me njësinë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit.

3. Kryerja e veprimtarive të jashtme duhet t'i njoftohet paraprakisht drejtuesit të institucionit dhe njësisë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore.

4. Veprimtaritë, në kuadër të veprimtarive sindikale ose të përfaqësimit të punëmarrësve ose veprimtaritë mësimdhënëse, janë të lejueshme kur ato nuk pengojnë në kryerjen e detyrës.

Neni 19

Prona shtetërore

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve mbron dhe ruan pronën e institucionit, përfshirë këtu edhe dokumentacionin zyrtar. Ai nuk duhet të përdorë ose të lejojë që të përdoret prona që institucioni zotëron ose ka në përdorim, për asnjë qëllim tjetër, përveçse për kryerjen e veprimtarive të miratuara, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve duhet të përdorë mjetet që i ofron pozicioni i punës vetëm për realizimin e detyrave të tij dhe jo për qëllime personale.

Neni 20

Koha e punës

Punonjësi i Policisë së Burgjeve duhet ta përdorë kohën e punës në mënyrë efektive për realizimin e detyrave. Kjo kohë nuk përdoret për asnjë qëllim tjetër, përveçse në rastet kur përdorimi i saj për qëllime të tjera është i autorizuar zyrtarisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 21

Konflikti i interesave

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve kryen detyrat në mënyrë të tillë që veprimtaria e tij të mos ndikohet nga interesat personalë.

2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve identifikon rrethanat që mund ta përballin atë me një konflikt të mundshëm interesi.

3. Konflikti i interesave është situata në të cilën një punonjës i Policisë së Burgjeve ka një interes personal, që ndikon ose mund të ndikojë në paanshmërinë ose objektivitetin e kryerjes së detyrës.

4. Interesat personalë të punonjësit të Policisë së Burgjeve përfshijnë çdo përparësi për veten, familjen, të afërmit deri në shkallën e dytë, si dhe personat ose organizatat me të cilat punonjësi ka ose ka pasur marrëdhënie biznesi ose lidhje politike.

5. Punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk duhet të ushtrojë veprimtarinë e tij, me qëllim përfitimin personal apo në favor të personave të tretë, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi.

6. Në rast se punonjësi i Policisë së Burgjeve ka dijeni për ekzistencën e një situate të tillë, ai është i detyruar:

- a) të verifikojë nëse ka një konflikt aktual të mundshëm interesash;
- b) të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të shmangur një konflikt të tillë;
- c) të vërë në dijeni menjëherë, eprorin direkt dhe njësinë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore për konfliktin aktual ose të mundshëm të interesave;
- ç) të këshillohet me eprorin direkt ose/dhe me njësinë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, në rast dyshimi për gjendjen në një situatë konflikti interesash;
- d) t'i bindet çdo vendimi përfundimtar për të mos marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes ose të heqë dorë nga përparësitë, që shkakton konfliktin.

Neni 22

Dhuratat dhe favoret

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk duhet të kërkojë ose të pranojë, dhurata, favore, pritje ose çfarëdo përfitim tjetër, ose shmangie të humbjeve të mundshme, si dhe premtime për to, për veten, familjen, të afërmit, personat ose organizatat me të cilat ka marrëdhënie, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës, apo janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës.

2. Në qoftë se punonjësit të Policisë së Burgjeve i ofrohet një avantazh i padrejtë, ai duhet:

- a) ta refuzojë, pa pasur nevojë ta pranojë atë për ta përdorur si provë;
- b) të përpiqet që ta identifikojë personin që i bën ofertën;
- c) të shmangë kontaktet e gjata me personin që bëri ofertën, por dijenia e arsyes për të cilën bëhet oferta, mund të shërbejë si provë;
- ç) në qoftë se dhurata nuk mund të refuzohet që t'i kthehet dërguesit, duhet të ruhet, të përdoret sa më pak që të jetë e mundur dhe t'i raportohet menjëherë eprorit direkt;
- d) të ketë dëshmitarë, nëse është e mundur, kolegët që punojnë me të;

dh) të raportojë përpjekjen, sa më shpejt që të jetë e mundur, tek eprori i tij ose te njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore;

e) të vazhdojë punën normalisht, sidomos për problemin për të cilin avantazhi i padrejtë është ofruar.

Neni 23

Përdorimi i informacionit

Punonjësi i Policisë së Burgjeve pas largimit nga detyra nuk duhet ta përdori informacionin konfidencial, të marrë gjatë kryerjes së detyrës, për interes personal, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ruajtjen e sekretit shtetëror dhe hetimor.

KREU IV

KOMISIONI I ETIKËS

Neni 24

Komisioni i etikës

1. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ngrihet Komisioni i etikës, i cili shqyrton çështjet e paraqitura për zbatimin e rregullave të etikës dhe të sjelljes profesionale të punonjësve të Policisë së Burgjeve.

2. Komisioni i etikës është një organ këshillimor, vendimet e të cilit nuk janë të detyrueshme për organin kompetent për vendosjen e masave disiplinore.

3. Komisioni i etikës përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë:

- a) zëvendësdrejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në cilësinë e kryetarit;
- b) drejtori i njësisë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, në cilësinë e anëtarit;
- c) drejtori i njësisë juridike në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, në cilësinë e anëtarit;
- ç) shefi i sigurisë në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, në cilësinë e anëtarit;
- d) përgjegjësi i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale ku është i punësuar punonjësi, në cilësinë e anëtarit.

4. Shqyrtimi i çështjes bëhet në mbledhje me dyer të mbyllura, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur ose të mbledhur kryesisht nga Komisioni. Në raste përjashtimore dhe nëse vlerësohet e nevojshme, Komisioni mund të thërrasë për të dhënë deklaratime punonjës të Policisë së Burgjeve.

5. Anëtar i Komisionit nuk përfshihet në procedurën e shqyrtimit, në rastet kur ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim ose në rastin kur është vetë subjekt i shqyrtimit.

6. Komisioni është i detyruar të përfundojë procedurën e shqyrtimit të shkeljes së etikës apo të sjelljes profesionale, me vendim me shkrim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e fillimit të procesit për verifikimin e shkeljes.

7. Komisioni mund të vendosë:

- a) rekomandimin për fillimin e një procesi disiplinor ndaj punonjësit që ka kryer shkeljen e rregullave të etikës apo të sjelljes profesionale;
- b) rekomandimin për dhënien e masës disiplinore konkrete; ose
- c) mosfillimin e një procesi disiplinor kur nuk konstaton shkelje.

8. Vendimi i Komisionit të etikës, nëse konfirmohet shkelja e pretenduar, i përcillet organit që ka kompetencën për të dhënë masën disiplinore brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e tij.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 25

Dispozitë zbatuese

1. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore është e detyruar t'i bëjë të ditur punonjësit të Policisë së Burgjeve, në çastin e punësimit të tij detyrimet që rrjedhin nga ky Kod dhe që duhen respektuar nga punonjësi.

2. Punonjësi ka për detyrë të sillet në përputhje me këtë Kod dhe, për këtë arsye, informohet për dispozitat e tij dhe për çdo ndryshim ose shtesë.

3. Punonjësi duhet të kërkojë këshillim nga njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit kur është i pasigurt për të vepruar.

4. Dispozitat e këtij Kodi janë pjesë e kushteve të punësimit të punonjësit. Shkelja e tyre bëhet shkak për marrjen e masave disiplinore.

5. Eprori i punonjësit të Policisë së Burgjeve ka përgjegjësi të kontrollojë nëse ai zbaton rregullat e treguara në këtë Kod dhe propozon ose merr masat e duhura disiplinore për shkeljet e tij, sipas legjislacionit në fuqi për Policinë e Burgjeve.

Neni 26

Masat disiplinore

Punonjësi i Policisë së Burgjeve që nuk respekton apo shkel parimet e etikës dhe të sjelljes profesionale, të përcaktuara në këtë Kod, kur veprimet e tyre nuk përbëjnë vepër penale, ndëshkohen me masat disiplinore, sipas procedurës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi për Policinë e Burgjeve.